



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE**

Adresa: Rr. "Abdi Toptani" Nr.4, Kati 4, Tiranë, Shqipëri.  
Tel: +355 4 2235569, +335 4 2235572  
Website: [www.amshc.gov.al](http://www.amshc.gov.al) E-mail: [info@amshc.gov.al](mailto:info@amshc.gov.al)

17.06.2014

Përshëndetje,

Në këtë mes viti 2014, në vijim të mbështetjes për shoqërinë civile, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) po zhvillon Thirrjen e 5-të për projekt propozime drejtuar Organizatave Jo Fitimprurëse (OJF) që veprojnë në Shqipëri. Kësaj thirrjeje i parapriu zgjedhja e Bordit të ri Mbikqyrës, i cili përbëhet nga 9 anëtarë, ku 5 anëtarë përfaqësojnë organizatat e shoqërisë civile dhe 4 anëtarë përfaqësojnë institucionet e administratës publike qendrore. Ky Bord përzgjodhi Drejtorin e ri Ekzekutiv, Z. Andi Kananaj më 26 maj 2014.

Misioni themelor i AMSHC-së është nxitja nëpërmjet asistencës financiare, e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile, në të mirë dhe në interes të publikut. Lidershipi i ri i Agjencisë po punon për hartimin e një strategjie afatgjatë për të pëmbushur këtë mision. Në këtë proces Agjencia është e hapur të përfshijë aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile si OJF, nisma qytetare, institucione akademike, qendra kërkimore, fondacione, partnerë ndërkombëtarë, pushtetin qendror dhe lokal etj. Në këtë kuadër jeni të ftuar të jepni kontributin tuaj në hartimin e strategjisë sonë afatgjatë.

Thirrja e 5-të për projekt propozime deri tani ka pasur një interes të lartë nga shoqëria civile; ky fakt u vu re gjatë seancave orientuese në datat 12 dhe 13 Qershor 2014, ku u ftuan organizata për të marrë informacion dhe udhëzime në lidhje me plotësimin e formularit të aplikimit dhe dokumentacioneve përcjellëse. Gjatë këtyre dy ditëve morën pjesë mbi 100 përfaqësues organizatash të cilët morën pjesë aktivisht me pyetje dhe sugjerime. Fushat për këtë thirrje mbulojnë: Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit; Forcimi i institucionit të tolerancës dhe dialogut si vlera themelore të demokracisë; Mbrojtja e mjedisit; Fuqizimi i kapaciteteve të brezit të ri; Promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore; Fuqizimi i bashkëpunimit midis organizatave të shoqërisë civile; Forcimi i kapaciteteve të organizatave; Nxitja e përfshirjes së shoqërisë civile në politikë-bërje dhe në vendimmarrje. Për më tepër informacion rreth Thirrjes së 5-të, vizitoni faqen tonë [www.amshc.gov.al](http://www.amshc.gov.al).

Për të qenë sa më transparentë dhe të hapur ndaj bashkëpunimit me shoqërinë civile, AMSHC-ja ka vënë gjithashtu në përdorim mjete të tjera komunikimi inovative dhe interaktive, si rrjetet sociale (klikoni [këtu](#) për faqen Facebook, dhe [këtu](#) për të na ndjekur në Twitter) dhe një forum online ([www.amshc.gov.al/forum](http://www.amshc.gov.al/forum)).

Në muajt pasardhës dhe në vazhdimësi shpresojmë të krijojmë impakt në nxitjen e zhvillimit të shoqërisë civile në Shqipëri me punën tonë dhe me ndihmën e asistencën tuaj.

Skuadra e AMSHC-së